

Kapitulli 15 i Raportit të Progresit 2025 të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe roli i Entit Rregullator të Energjisë (ERE)

Më datë 4 nëntor 2025, u prezantua Raporti i Progresit të Integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian për vitin 2025. Kapitulli 15, i çelur plotësisht në shtator të këtij viti mbulon kuadrin e politikës së BE-së për energjinë, që përfshin sigurinë e furnizimit, tregun e brendshëm të energjisë, burimet e rinovueshme, efikasitetin energjetik dhe mbrojtjen e konsumatorit. Enti Rregullator i Energjisë (ERE) zë një rol thelbësor në procesin e përafrimit të Shqipërisë me *acquis communautaire* të BE-së, si rezultat, Raporti i Progresit për vitin 2025 nënvizon se veprimtaria e ERE-s është një element kyç në ndërtimin e tregut të brendshëm të energjisë, në liberalizimin e çmimeve, si dhe në zbatimin e rregulloreve të reja të integritit të tregut rajonal.

Në këtë kontekst, ERE është vlerësuar si institucioni rregullator që po përforcon kapacitetet e veta për të përmbushur nevojat e sektorit, duke kontribuar drejtpërdrejt në përgatitjen e vendit për integrim të plotë në Tregun e Energjisë të Bashkimit Evropian dhe Komunitetin e Energjisë.

Në maj 2025, ERE miratoi Rregulloren për Ndarjen e Kapaciteteve dhe Menaxhimin e Ngarkesave (Capacity Allocation and Congestion Management) – një hap i rëndësishëm drejt përafrimit me Paketën e Integritit të Energjisë Elektrike të BE-së.

Në dhjetor 2024, ERE miratoi gjithashtu ndryshimet në rregullat e tregut të energjisë elektrike, të cilat ishin përafuar me Rregulloren e Tregut të Energjisë Elektrike të BE-së dhe me vendimet e Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER), duke mundësuar funksionimin e plotë të tregut të përbashkët Shqipëri – Kosovë (ALPEX) për tregtimin brenda ditës dhe të ditës në avancë të energjisë. Ky zhvillim përfaqëson një moment historik për integrimin rajonal të tregjeve të energjisë në Ballkanin Perëndimor, duke vendosur Shqipërinë si një aktor aktiv në Single Day-Ahead Coupling (SDAC) dhe Single Intraday Coupling (SIDC).

Në tetor 2024, ERE ndërmori një ristrukturim të brendshëm organizativ, duke krijuar njësi të reja për burimet e rinovueshme dhe përputhshmërinë rregullatore. Ky riorganizim është cilësuar nga Komisioni Evropian si një zhvillim që forcon kapacitetet teknike dhe administrative të ERE-s, për të përmbushur standardet e reja të sektorit dhe për të mbështetur procesin e tranzicionit energjetik të vendit.

Në dhjetor 2024, ERE miratoi Rregulloren për lëshimin, transferimin dhe anulimin e Garancive të Originës (GOs) për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e

rinovueshme, duke i dhënë tregut shqiptar të energjisë një mekanizëm të ri për certifikimin e energjisë së gjelbër. Ky sistem elektronik i garancive të origjinës tashmë është i aksesueshëm për të gjithë pjesëmarrësit në treg, duke rritur transparencën dhe besueshmërinë e tregtisë me energji të rinovueshme. Ky hap është vlerësuar si një komponent kyç për të arritur objektivin kombëtar prej 300 MW kapacitet të ri deri në vitin 2027, në vijim të 860 MW të alokuar përmes procedurave konkurruese që nga viti 2019.

Megjithë përparimin e dukshëm, raporti thekson disa sfida me rëndësi për ERE dhe për institucionet e sektorit energjetik, si përfundimi i përafrimit të plotë me Paketën e Integritit të Energjisë Elektrike, që kërkon miratimin e plotë të Ligjit të ri për Sektorin e Energjisë Elektrike; vazhdimi i liberalizimit të tregut të energjisë, ku ende mbeten të rregulluar konsumatorët e tensionit të ulët (0.4 kV); rritja e kapaciteteve teknike dhe trajnimi i stafit të ri të ERE, në funksion të detyrave të reja dhe kompleksitetit të rregullimeve europiane; spo dhe ndërtimi i mekanizmave të monitorimit dhe përputhshmërisë, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe mbikëqyrjes së operatorëve të tregut.

Enti Rregullator i Energjisë është një nga institucionet shqiptare me ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e integritit në Bashkimin Evropian, duke qënë garant i funksionimit të tregut të energjisë në përputhje me rregullat dhe direktivat e BE-së. Nëpërmjet vendimeve rregullatore, standardeve teknike dhe mbikëqyrjes së tregut, siguron stabilitet, konkurrueshmëri dhe transparencë në sektorin energjetik, duke krijuar kushtet e nevojshme për tërheqjen e investimeve të huaja dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP 2021–2030).

Raporti i Progresit 2025 konfirmon se ERE po luan një rol kyç në përafrimin e Shqipërisë me politikat e energjisë të BE-së, me reformat e ndërmarra, rritjen e kapaciteteve të brendshme dhe krijimin e instrumenteve të reja rregullatore, ERE po konsolidohet si institucioni themelor për një treg të qëndrueshëm, të hapur dhe të integruar energjie në Shqipëri dhe në rajon.

Burim zyrtar: [European Commission – Albania 2025 Report \(English PDF\)](#)